1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

**26. Anulimi i
procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose

aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

-
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant per ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët*]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publike dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Karakteristikat teknike minimale të lëndës djegëse pellet:

- Lloji i drurit: Ah ose lis (vetëm tallash i pastër, jo lëvozhga druri)
- Vlera kalorike: $\geq 4.6 \text{ kWh/kg}$ (16.5 MJ/kg)
- Qëndrueshmëria mekanike $\geq 98 \text{ w-\%}$
- Përmbajtja e lagështisë: $\leq 10 \%$
- Përmbajtja e pluhurit: $\leq 0.7\%$
- Densiteti: $750 \text{ kg/m}^3 \leq D \leq 600 \text{ kg/m}^3$
- Paketimi: 10-20 kg
- Gjatësia: $3.15\text{mm} \geq L \leq 40 \text{ mm}$
- Diametri: $6 \pm 1 \text{ mm}$

Malli duhet të jetë i paketuar me ambalazhim plastik rezistent ndaj procesit të transportit dhe shpërndarjes nëpër objekte. Në ambalazhin e mallit duhet të pasqyrohet qartë me shkrim lloji i mallit, specifikimet kryesore teknike, (psh. Vlera kalorike, Gjatësia, përmbajtja e lagështisë etj.) emërtimi dhe prodhuesi. Të gjitha paketimet, etiketimet dhe dokumentacioni shoqërues i mallrave objekt prokurimi duhet të jenë në përputhje me bazën ligjore në fuqi, referuar Ligjit nr. 10480 datë 17.11.2011, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore", Ligjit nr. 10489 datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore" dhe Ligjit Nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër me punonjësit e vet dhe me automjetet e veta të realizojë shpërndarjen, ngarkim, stivosje dhe shkarkim të pelletit në sasi dhe kohën e caktuar, në objektet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Shtojca 6

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi i mallrave	Njësia	Sasia
1	Lëndë djegëse pellet për ngrohje dhe shpërndarje në objektet arsimore	kg	1 064 321

Sasia e shprehur me fjalë: një milion e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e njëzet e një, kilogramë.

Grafiku i lëvrimit të mallit do të njoftohet nga autoriteti kontraktor krahas çdo minikontrate që do të lidhet në zbatim dhe brenda afatit të marrëveshjes kuadër.

Afatet e lëvrimit:

Artikulli Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Lëndë djegëse pellet për ngrohje dhe shpërndarje në objektet arsimore	kg	1 064 321	DPOP	12 muaj

Shpjegim i termave: **DPOP** → Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë

TABELA ME PARASHIKIMIN E SHPËRNDARJES SË LËNDËS DJEGËSE NË OBJEKTET ARSIMORE

INSTITUCIONET ARSIMORE				Sasia në (kg) e pritshme për muajin Nentor 2023	Sasia në (kg) e pritshme për muajin Dhjetor 2023	Sasia në (kg) e pritshme për muajin Janar 2024	Sasia në (kg) e pritshme për muajin Shkurt 2024	Sasia në (kg) e pritshme për muajin Mars 2024	Sasia totale (kg) sipas orëve bazë të punës periudhën 15 Nentor 2023-15 mars 2024
Nr.	Objekti arsimor	Njësia Administrative	Adresa e objektit						
1	Shk. "1 Maji"	Nj. Ad. Nr.1	Rr."A.Demi"	2950	4425	6195	6195	2950	22715
2	Shk."Ali Demi"		Rr."A.Demi"	1450	2175	3045	3045	1450	11165
3	Kop. Nr. 24		Rr."Asdreni"	680	1360	1428	1428	680	5576
4	Cerdhja Nr. 50		Rr."Pasho Vaso"	720	1440	1512	1512	720	5904
5	Cerdhja Shkoze Nr.60		Rr."Asdreni"	1160	2320	2436	2436	1160	9512

6	Shk."Ismail Qemali"	Nj.Ad.Nr.2	Bulevardi Zhan Dark	2280	3420	4788	4788	2280	17556
7	Shk. "Fan Noli"		Rr."Q.Stafa"	3550	5325	7455	7455	3550	27335
8	Shk. "H.Tahsim"		Rr."H.Tahsim"	2280	3420	4788	4788	2280	17556
9	Shk. "M.Grebleshi"		Sauk	3750	5625	7875	7875	3750	28875
10	Shk."Mihal Grameno"		Rr."Mihal Grameno"	3750	5625	7875	7875	3750	28875
11	Shk. "I.Brahja"		Sauk i Vjetër	3000	4500	6300	6300	3000	23100
12	Shk. "Kosova"		Rr."Labinoti"	2250	3375	4725	4725	2250	17325
13	Kopshti Nr.18		Rr."Mihal Grameno"	640	1280	1344	1344	640	5248
14	Cer. Nr. 51	Rr."Asdreni"	680	1360	1428	1428	680	5576	
15	Shkolla "Andon Zako Cajupi"	Nj. Ad. Nr.3	Rr."Kongresi i Manastirit"	2280	3420	4788	4788	2280	17556
16	Kop.Nr.1		Rr."Q.Stafa"	720	1440	1512	1512	720	5904
17	Kop.Nr.20		Rr."Teli Ndini"	480	960	1008	1008	480	3936
18	Cer.Nr.15		Rr."Q.Stafa"	680	1360	1428	1428	680	5576
19	Shk."E.Çabej"	Nj. Ad. Nr.4	Rr."Dibrës"	2430	3645	5103	5103	2430	18711
20	Shk."Gj.Buzuku"		Rr."K.Manastirit"	2400	3600	5040	5040	2400	18480
21	Shk."Ardian Klosi"		Rr."Selaudin Bektashi"	2250	3375	4725	4725	2250	17325
22	Kop.Nr.25/A		Rr."N.Avrani"	720	1440	1512	1512	720	5904
23	Kop.Nr. 39		Rr."Dibrës"	720	1440	1512	1512	720	5904
24	Kopesht+Çerdhe e Re (A.Klosi)		Rr."Selaudin Bektashi"	520	1040	1092	1092	520	4264
25	Shk."Vasil Shanto"	Nj. Ad. Nr.5	Rr."Bajram Curri "	1800	2700	3780	3780	1800	13860
26	Shk."Vasil Shanto" per shk. "Emin Duraku"			1200	1800	2520	2520	1200	9240
27	Shk."Murat Toptani"		Selite	2250	3375	4725	4725	2250	17325
28	Shk. Mesme "Betim Muço"	Nj. Ad. Nr.6	Rr."Llazi Miho"	2280	3420	4788	4788	2280	17556
29	Shk. Mesme "Betim Muço" per shk."M. Kokalari"			1520	2280	3192	3192	1520	11704
30	Shk."IQershori"			2280	3420	4788	4788	2280	17556
31	Shk."Lazgush Poradeci"			5000	7500	10500	10500	5000	38500
32	Kop. Nr. 21/K		Rr."H.Cenojmeri"	1000	2000	2100	2100	1000	8200
33	Kop. Nr. 38/K		Fabrika e Qelqit	480	960	1008	1008	480	3936
34	Kop Nr.34			920	1840	1932	1932	920	7544
35	Shk. "Dhora Leka"		Nj. Ad. Nr.7	Fusha Aviacionit	3000	4500	6300	6300	3000
36	Shk. "Sabaudin Gabrani"	Rr. "Muamet Gjollështa"		1830	2745	3843	3843	1830	14091
37	Shk. "Sabaudin Gabrani" per shk. "Emin Duraku"			1220	1830	2562	2562	1220	9394
38	Kop.Nr.2	Rr."Frederik Shiroka"		720	1440	1512	1512	720	5904
39	Kop.Nr.17	Rr."		480	960	1008	1008	480	3936
40	Shkolla "4 Deshmorët"	Nj.Ad.Nr.8	Rr."4 Deshmorët"	2160	3240	4536	4536	2160	16632
41	Shkolla "Siri Kodra"		Rr."S.Kodra"	1020	1530	2142	2142	1020	7854
42	Kopshti Nr.6		Rr."Dibrës"	520	1040	1092	1092	520	4264
43	Kopshti Nr.35		Rr."4 Deshmorët"	840	1680	1764	1764	840	6888
44	Shkolla "Sinan Tafaj"	Nj. Ad. Nr.9	Rr."Maliq Muço"	2280	3420	4788	4788	2280	17556
45	Shk."Hasan Vogli"		Rr."Barrikadave"	1350	2025	2835	2835	1350	10395
46	Shk."Qazim Turdiu"			3000	4500	6300	6300	3000	23100
47	Shk."J.De Rada"		Rr."Mehmet Broca"	3750	5625	7875	7875	3750	28875
48	Shk."Servete Maci"		Rr."Dibrës"	2430	3645	5103	5103	2430	18711
49	Kopshti Nr.3		Rr."H.H.Dalliu"	720	1440	1512	1512	720	5904
50	Shkolla Mesme "Qemal Stafa"	Nj. Ad. Nr.10	Rr."K.Përmeti"	2340	3510	4914	4914	2340	18018
51	Shkolla Mesme "Qemal Stafa" per shk."Asim Vokshi"			1560	2340	3276	3276	1560	12012
52	Shk."Konferenca e Pezes"		Rr."Him Kolli"	1200	1800	2520	2520	1200	9240
53	Shkolla Mesme "Dora Distria"		Rr."Myslym Shyri"	1380	2070	2898	2898	1380	10626
54	Shkolla "Ahmet Gashi"	Nj. Ad. Nr.11	Rr."Pandi Dardha"	3250	4875	6825	6825	3250	25025
55	Shk."Isa Boletini"			2400	3600	5040	5040	2400	18480
56	Kopshti Nr.14		Rr."Pandi Dardha"	720	1440	1512	1512	720	5904
57	Kopshti Bregu i Lumit		Bregu i Lumit	520	1040	1092	1092	520	4264
58	Kop "Koder Kamez" 63		Institut Bujqësor	480	960	1008	1008	480	3936
59	Çerdhja Nr.30		Rr."Pandi Dardha"	640	1280	1344	1344	640	5248
60	Çerdhja Kodër Kamëz		Instituti Bujqësor	480	960	1008	1008	480	3936

61	Shkolla 9-vjeçare "Feti Fanaj"		Mangull	540	810	1134	1134	540	4158	
62	Kopshti "Fikas"	Nj. Ad. Petrele		300	600	630	630	300	2460	
63	Kopshti "Gurre"			300	600	630	630	300	2460	
64	Shk.M.P "Ymer Lala" Surrel		Nj.Ad.Dajt	Fshati Surrel	1200	1800	2520	2520	1200	9240
65	Shk.9-vj "Bashkim Berisha", Ndroq	Nj.Ad.Ndroq	Fshati Ndroq	870	1305	1827	1827	870	6699	
66	Shk. "Lalm"	Nj.Ad.Vaqarr		750	1125	1575	1575	750	5775	
67	Shk.9-vj "Agron Hysenliu"	Nj.Ad. Pezë	Pezë e vogël	1050	1575	2205	2205	1050	8085	
68	Shkolla 9 vjeçare "16 Shtatori"				2100	3150	4410	4410	2100	16170
69	Shkolla "Pajan"				870	1305	1827	1827	870	6699
70	Shk. "Peze Helmes"				3000	4500	6300	6300	3000	23100
71	Shk.Dritas			1080	1620	2268	2268	1080	8316	
72	Shk.Qesarak e vjetër			1350	2025	2835	2835	1350	10395	
1	Shkolla "Koçaj"	Nj.Ad. Baldushk		8	480	720	1008	480	3696	
2	Shkolla 9-vjeçare "Fushas"			9	900	1350	1890	900	6930	
3	Shkolla "Baldushk"			14	840	1260	1764	840	6468	
4	Shkolla 9-vjeçare Bërzhit	Nj. Ad. Berzhit		10	600	900	1260	600	4620	
5	Shkolla "Flamur Shkoza"	Nj. Ad. Dajt		11	660	990	1386	660	5082	
6	Shkolla Mesme "Sadi Nuri"	Nj. Ad. Ndroq		13	780	1170	1638	780	6006	
7	Shkolla "Alush Bardhi", Farke e Madhe	Nj.Ad. Farke		19	1900	2850	3990	1900	14630	
8	Shkolla "Arbanë"	Nj.Ad. Vaqar		12	720	1080	1512	720	5544	
9	Shk. "Pjeter Budi"	Nj.Ad. Nr.7		33	3300	4950	6930	3300	25410	
10	Shkolla "E Kuqe"	Nj.Ad. Nr.8		27	1620	2430	3402	1620	12474	
11	Shkolla "E Kuqe" per shk. "Partizani"				27	1080	1620	2268	1080	8316
12	Shk. "Sander Prosi"	Nj.Ad. Nr.2		12	720	1080	1512	720	5544	
13	Shkolla 9-vjeçare "Bahri Nela"	Nj. Ad. Zall Bastar		15	900	1350	1890	900	6930	
14	Shkolla 9 Vjeçare "Mustafa Kemal Atatürk"	Nj. Ad. Zall Herr		12	720	1080	1512	720	5544	
15	Shkolla "Haki Shehu"	Nj. Ad. Petrele		8	480	720	1008	480	3696	
16	Shk. "Edit Durham"	Nj.Ad. Nr.5		5	500	750	1050	500	3850	
17	Shk. "Katund I Ri"	Nj.Ad. Kashar		3	180	270	378	180	1386	
18	Shk. "Yrshek"				10	600	900	1260	600	4620
19	Shk. "Kasem Shima"				10	1000	1500	2100	1000	7700
20	Shk. "Yzberisht"				21	2100	3150	4410	2100	16170
21	17 Shkurti			32	1920	2880	4032	1920	14784	
22	Shkolla Zall Dajt			6	360	540	756	360	2772	
Totali					137,130	214,115	287,973	287,973	137,130	1,064,321

Afatet e dorëzimit: Sasia e pritshme e mallit, e pasqyruar në tabelën e mësipërme, do të dorëzohet brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga nënshkrimi i projekt-marrëveshjes kuadër, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Shtojca 7

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
 - b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
 - c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
 - ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
 - d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 - f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
 - gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
 - h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
 - i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

2.1.3 Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shënim: Ky kriter (2.1.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësisht dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues (akreditimi i entit çertifikues) do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.1.4 Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë çertifikatat ISO të kërkuara janë të detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të jetë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues me seli (filial) në Republikën e Shqipërisë duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2022 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësisht dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktin objekt prokurimi. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/ distributori të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi (objekt, nr.REF), ose autorizim prodhuesi/ distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit. Në rast paraqitje deklarate furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues për realizimin në kohë të shërbimeve objekt të prokurimit duhet të ketë në pronësi ose mbështetje nga një operator ekonomik për të paktën 2 (dy) automjete ATP (automjet i transportit të përzier) dhe 1 (një) automjet kamion vinç me kapacitet ngritës jo më pak se 1.5 (një pikë pesë) ton dhe kapacitet mbajtës jo më pak se 5 (pesë) ton. Për këtë duhet të paraqesë, Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin dhe dokumentacionin për vlefshmërinë e tahogرافit + çertifikatën e transportit të mallrave në Bashkinë Tiranë për automjetin kamion vinç të vlefshme, ose në rast se nuk e ka automjetin në pronësi të paraqesë një deklaratë mbështetje nga një operator ekonomik ku të deklarohet se mbështetja e tij për këtë kapacitet teknik ofrohet për një afat sa kohëzgjatja e kontratës së parashikuar si dhe dokumentacionin shoqëruar për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin dhe dokumentacionin për vlefshmërinë e tahogرافit për automjetin kamion vinç + çertifikatën e transportit të mallrave në Bashkinë Tiranë) të vlefshme. Për çdo automjet duhet të paraqitet foto ku të dallohet qartë lloji i automjetit dhe targa e tij.

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raportet e testimin ose fletë analizat nga laboratorë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë për produktin objekt prokurimi me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara. Dëshmia me rezultatet e testeve zyrtare duhet të jetë lëshuar jo më parë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Dokumentacioni për akreditimin e laboratorit i cili ka lëshuar fletë analizat e kërkuara do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion në paketim origjinal për produktin objekt prokurimi. Mostra e kërkuar duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostra duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I.Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është

në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
